

PROCESVERBAL
nga seanca e 18-të e Këshillit të
Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
mbajtur më 01.06.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nuk ishte i pranishëm Dr. Zoran Trajçevski Drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (udhëtim zyrtar).

Udhëhqësi i Sektorit për financa dhe llogjistikë Goran Radunoviq e zëvendësonte drejtorin e Agjencisë, në përputhje me autorizimin nr.03-1452/1 me datë 28.03.2023.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional përmes video lidhjes: Goran Radunoviq, Maja Damevska, Mr. Ruzhica Boshnakovska Jotevska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 18-të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora. Seanca filloi në ora 09:10 dhe u mbajtë përmes video lidhjes.

Z. Petrushevski sqaroi se titulli i pikës së 2-të nga propozim rendi i ditës do të zëvendësohet me Propozim-Vendim për ndërprerjen e inicimit për marjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK STRUGË.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi të korigjuer:

RENDI I DITËS

1. Miratim i propozim-procesverbalit nga seanca e 17-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më datë 29.05.2023.
2. Propozim-vendim për ndërprejen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar të seancës së 17-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 29 maj 2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Shefi i Sektorit të Financave dhe Logjistikës, Goran Radunoviq, ka shpjeguar Propozim-vendimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për revokimin e licencës për

transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare JON-RADIO SHPK STRUGË. Ai ka shpjeguar se kjo Shoqëri tregtare radiodifuzive komerciale ka bërë pagesën e plotë të tarifës së licencës pas dorëzimit të faturës brenda afatit sipas ligjit dhe për këtë arsye propozohet ndërprerja e procedurës së filluar. Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, nr.08-234, datë 30.04.2019.

Sipas faturës së lëshuar, transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit radiofonik.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojnë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pas votimit, z. Petrushevski uroi që transmetuesi në të ardhmen të ketë rezultate më të mira financiare dhe vitin e ardhshëm të mos gjendet në këtë pozitë.

Pika3

Të ndryshme

Nuk kishte asnjë diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-2270/3

15.06.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v